



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:187038  
Datë: 28.03.2024  
Numri i dokumentit: 05516395

**Ac.nr.4813/2020**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Naim Mehulli dhe Enes Mehmeti - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A. K. nga fshati G.-Komuna e G., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit G. H., avokat nga G., kundër të paditurës Komuna e Gllogocit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson M. K. nga Avokatura Shtetërore e Ministrisë së Drejtësisë, me objekt kontesti kompensim i ndryshimit të pagës pas licencimit në shumën prej 638,00 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.208/16, të datës 14.09.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më 28.03.2024 nxjerr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gllogocit-Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.208/16, i datës 14.09.2020, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m i**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.208/16 të datës 14.09.2020, në pikën e parë të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses A.K. nga fshati G.-Komuna e G.. Në pikën e dytë të dispozitivit e ka detyruar të paditurën Komuna e Gllogocit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të ndryshimit të pagesës pas licencimit si mësimdhënëse në cikël të ultë në SHMFU “Mehtmet Gradica” në Gradicë, që t’ia paguaj shumën prej 638,00 euro për tri vite pas licencimit me kamata ligjore prej 8 %, nga dita e ushtrimit të kërkesëpadisë si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 529,00 euro dhe atë për përpilimin e padisë shumen prej 104 eur, për pagesë të taksës gjyqësore 20 euro dhe tri seanca të mbajtura nga 135 të gjitha në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënimin e përmbarimit.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur pala e paditur, për shkak të shkëljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta prishë aktgjykimin e atakuar duke e refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses.

Paditësja nuk ka ushtruar përgjegje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

### **Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja, A.K., përmes përfaqësuesit të saj autorizuar, Gazmend Halilaj, avokat nga Glllogoci, me datë 09.09.2016, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Glllogocit – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin në emër të ndryshimit të pagës për shkak të licencimit duke theksuar se e paditura ka qenë e obliguar ta bëjë pagesën e plotë për punën e kryer, konkretisht pagesa në emër të pagës bazë dhe beneficinet tjera siç është pagesa në emër të gradimit, mirëpo për punën e kryer nga ana e paditëses e paditura prej datës 01.09.2012, e deri me datë 01.05.2014, ka bërë vetëm pagesën e pagës bazë e jo edhe atë në emër të gradimit-licencimit duke i mbetur borxh tek e paditura në shumën prej 638.00 euro.

E paditura e ka kundërshtuar padinë e paditëses duke theksuar se paditësja nuk i ka shtjerr procedurat administrative lidhur me këtë çështje kontestimore duke u mbështetur në ligjin e punës 03/L-212, nenin 78 ku përcaktohet se duhet drejtuar inspektoratit të punës për të shqyrtuar çështje nga lëmia e të drejtave të marrëdhënies së punës, po ashtu mund të konstatohet fakti se paditësi-ja me ankesë ju është drejtuar Inspektoratit të arsimit e që rrjedhimisht kjo çështje kontestimore është dashur të shqyrtohet në departamentin e gjykatës kompetente, andaj Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc është inkompetente në raport me kërkesëpadinë. Tutje ka theksuar se bazuar në udhëzimet administrative nr. 1311 të datës 30.12.2011 për normtivë mbi kuadrin profesional është paraparë që mësimdhënësi dhe edukatorët të cilat kanë ushtruar veprimtarinë edukative dhe arsimore më shumë se tri vite obligohen të vazhdojnë arsimin profesional, paditësja ka punuar si mësimdhënëse e arsimit fillor kualifikimi i saj është basceller i pedagogjisë me sistemin tre vjeçar, ku dhe kuadër i këtij kualifikimi ka gëzuar të drejtën e pagës dhe nuk ka bazë ligjore që të paguhet në emër të gradimit ku paditësja nuk ka prezantuar diplomën e kryerjes së studimeve të masterit e paraparë me udhëzimin administrativ. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.208/16 të datës 14.09.2020, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata ka theksuar se në mes të palëve ndërgjyqëse kontestuese ishte ndryshimi i pagesës pas procedurës së licencimit, ku paditësja është licencuar me datën 13.06.2018 me nr. 100015858 e cila licencë gjendet në shkresat e lëndës. Mbi bazën e kësaj gjykata ka konstatuar se e paditura-Komuna e Glllogocit, Drejtoria për Arsim është dashur që paditëses t'ia bëjë pagesën e ndryshimit të pagës nga dita e licencimit të saj si formë e gradimit profesional në mënyrë retroaktive në shumën prej 638,00 euro me kamat ligjore prej 8 % nga dita e licencimit e deri në pagesën përfundimtare. Andaj, gjykata e aprovoj kërkesëpadinë e paditës duke e mbështet vendimin e saj në nenin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë dhe nenit 55 të Ligjit të Punës 03/L-212. Për kamatën ligjore vendosi sipas nenit 382 të LMD-së, ndërsa për sa i përket shpenzimeve të procedurës vendosi sipas nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Aktgjykimi i atakuar me ankesë është i rregullt në pikëpamje të strukturës dhe përmbajtjes duke përfaqësuar kështu një vendim i cili është koherent në pikëpamje logjike dhe juridike duke eliminuar çfarëdo kontradikte për ta kualifikuar si kundërthënës. Mënyra e zhvillimit të procedurës dhe e hartimit të vendimit nga gjykata e shkallës së parë kanë garantuar një proces të drejtë dhe të paanshëm duke u mbështetur për përfundimin e saj në themelin faktik dhe juridik të çështjes.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pa bazuara pretendimet ankimore e të paditurës për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, në raport me gradimin-licencimin, e kjo për arsyeje se me nenin me nenin 7 të Kontratave Kolektive të Arsimit në

Kosovë parashihet se “Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: 1.1 Mësimdhënës me Shkollë Normale 10% e pagës bazë, 1.2 Mësimdhënës me Shkollë të Lartë Pedagogjike dy vjeçare 19% e pagës bazë, 1.3 Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27% e pagës bazë, 1.4 Mësimdhënës me diplomë vjeçar, magistraturë/master dhe doktoratë 35% e pagës bazë, ndërsa me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/33 të datës 29.08.2008 parashihet se nga 1 Shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësve etj do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe bashkëpunëtorëve profesional, me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me një ngritje të pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktorate) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %, prandaj, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar. Po ashtu, edhe sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës numër 214/2023 të datës 05.10.2023 çështja e kompensimit mbi bazën e kualifikimit është trajtuar ashtu që sipas këtij mendimi “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008” si dhe “punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, Sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”.

Gjykata e Apelit e refuzon si të pa bazuar pretendimin ankimor të palës së paditur e cila në ankesë është thirr në institutin e parashkrimit të kërkesëpadisë së paditëses e kjo për faktin se gjatë procedurës së zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë, nga shkresat e lëndës vërtetohet se e paditura nuk ka ushtruar përgjegje me shkrim në padinë e paditëses, ndërsa në seancën përgatitore të datës 28.02.2020 nuk është thirr në institutin e parashkrimit dhe një pretendim të tillë e ka paraqitur vetëm në ankesë, kurse sipas nenit 180 paragrafi 3 të LPK-së “Prapësimi i parashkrimit dhe prapësimi me qëllim kompensimi, që nuk janë paraqitur në gjykimin e shkallës së parë, nuk mund të paraqiten me ankesë”.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses që në emër të kompensimit për licencim t’ia kompensojë shumën e aprovuar si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjithashtu, edhe vendosja lidhur me kamatëvonesën, është në përputhje të plotë me nenin 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton detyrimin e debitorit në pagesën e kamatëvonesës si pasojë e vonesës në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit, e në rastin konkret e paditura meqë, është vonuar dhe nuk ka përmbushë detyrimin e saj ndaj kreditorit në afatin e

përcaktuar me kontratë kolektive, atëherë e njëjta i detyrohet në përmbushjen e detyrimit së bashku me kamatëvonesën në shkallë prej 8% vjetore.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat neni e 452 të LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të paditurës, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.4813/2020 datë 28.03.2024**

**Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,**  
**Ardian Ajvazi**